Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0600

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Arianit R. Bytyqi", kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të "Komuna E Podujevës" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor" me numër të prokurimit 615-22-11546-2-1-1, me 06/12/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht ankesa e OE "Arianit R. Bytyqi", me nr. 2023/0600 , e datës 21/08/2023, kurse vendimi i AK "Komuna e Podujevës" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor" me numër të prokurimit 615-22-11546-2-1-1, anulohet ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Arianit R. Bytyqi"- Prishtinë, sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.10.2022, "Komuna e Podujevës" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor" me numër të prokurimit 615-22-11546-2-1-1. Ndërsa me datën 02.08.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK për anulimin e aktivitetit te prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 183,750.00 €.

Me 07.08.2023, OE "Arianit R. Bytyqi", ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 10.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Arianit R. Bytyqi".me nr. 600/23 lidhur me aktivitetin "Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor" me numër të prokurimit 615-22-11546-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Ankesa pohimet ankimore OE "Arianit R. Bytyqi"-

Pretendimi i parë (I) ankuesi pretendon se: "Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- Komuna e Podujevës nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 72. Arsye e anulimit te aktiviteti të prokurimit është në kundërshtim me këto dispozita pasi nuk plotësohen konditat dhe kushtet që një aktivitet i prokurimit të anulohet sipas LPP-së neni 72. Vendimi mbi anulimin i datës 02.08.2023 është në kundërshtim me dispozitën ligjore LPP dhe RROUP dhe Vendimin PSH OSHP 2023/0151 3 1.05.2023. Ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar nga dt. 02.08.2023 për OE Arianit R. Bytyqi " B.I. NTSH UNISOFT, Prishtinë si arsyetim i eliminimit është: l. Mungojnë disa pika nga specifikacioni.

Pretendimi dytë (II) ankimor se ungon dokumenti ku vërteton te drejtën e pronësisë së materialeve. Ne si OE Arianit R. Bytyqi B .I. NTSH UNISOFT, kemi paraqitur argumente të mjaftueshme të cilat janë vërtetua edhe gjatë prezantimit dhe në sqarimin e kërkuar nga AK se ne si OE i plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit, specifikacionit teknik lidhur me kërkesat te cilat AK ka vendosur. Gjithashtu ne si OE kemi të bashkangjitura edhe liqet për verifikim online të gjitha pretendimeve. Manualet e përdorimit dhe video Incizimet. Nëse AK

KK Podujevë, nuk ka mundur ta vlerësoj ofertën , apo ka paqartësi rreth pikave të lartpërmendura, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59, pika 2. dhe nenit 72 të LPP-së. Platforma jonë e-ditari i plotëson te gjitha kërkesat si vijon , pos kërkesave të cilat janë kërkuar nga AK KK Podujeve, platforma jonë ofron edhe opsione shtesë te cilat janë prezantuar gjatë prezantimi me dt. 17.01.2023.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Arianit R. Bytyqi". konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, parag 1, neni 7 parag 1,2,3,4,6, nenin 59 parag 1,3,4, nenin 62 parag 1,2, si dhe nenin 72 parag 1,2,3 të LPP-së.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP-së, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Raporti i Ekspertit Shqyrtues-administrimi dhe vlerësimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 24/08/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 600/23, ndërsa me datë 03/09/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0600 me rekomandim si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Arianit R. Bytyqi" ankues të aprovohet e bazuar, dhe rekomandon që të anulohet B58 - Njoftimi mbi Vendimin AK dhe që lënda të kthehet në Rivlersim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, "Autoriteti kontraktues Nuk Pajtohet. Ndërsa OE Pajtohet me rekomandimin e eksperti.

Eksperti shqyrtues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit ankesa e dorëzuar në OSHP është për herë të dytë, ku paraprakisht është trajtuar ankesa dhe është Vendimi i OSHP-së me nr. 2023/0151. Pretendimi ankimore ka të bëjë me specifikcionet teknike.

Lidhur me pretendimi ankimor të OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Specifikacionet teknike të detyrueshme te kërkuara në dosjen e tenderit, Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues " Arianit R. Bytyqi " në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij

të dorëzuar me datë 30/11/2022, ka dorëzuar Deklaratë për Specifikikimin Teknike, Deklaratë për pronësi dhe të drejtë Autoriale, Deklaratë për mirëmbajtje dhe garancion, deklaratë për aftësi teknike dhe profesionale (dëshmi për zhvillim dhe prodhim softuer) . Sipas Vendimi të OSHP-së i datës 31/05/2023 lënda është kthyer në rivlerësim dhe Autoriteti Kontraktues gjatë ri vlerësimit të ofertave me datën 06.07.2023 përmes e-prokurimit ka kërkuar sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik ankues " Arianit R. Bytyqi " duke përdorë formularin B47 Letër Standarde e Kërkesës për sqarimin e tenderit . Operatori Ekonomik ankues " Arianit R. Bytyqi " me datën 07.07.2023 përmes e-prokurimit ka ngarkuar sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas kërkesës në letrën standarde. Dokumentet e kërkuara përmes letrës standarde nga AK, Operatori Ekonomik ankues " Arianit R. Bytyqi " ka dorëzuar materialet e platformës Shtojca që ka 38 faqe, deklaratën për Vërtitësin drejtës së pronësisë, Aneksi1 SpecifikacioniTeknik i vulosur dhe i nënshkruar. Eksperti shqyrtues, konstaton se OE ankues i plotëson të gjitha kriteret, specifikacionet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit dhe se pretendimi ankimore i OE është i bazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 1, 7 pasi qe OE ankues pretendon se i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara duke përfshirë edhe specifikacionet teknike të kërkuara.Autoriteti Kontraktues ka bërë anulimin në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-së, pasi qe sipas nenit 62.2.1 të LPP-së, AK mund të përfundojë një aktivitet të prokurimit nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime qe e tejkalojnë buxhetin e Autoritetit Kontraktues gjë e cila në këtë rast nuk ka qenë bazë për anulim.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues* -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor" me numër të prokurimit 615-22-11546-2-1-1.

Paneli shqyrtues vëren se Letra standarde AK për tenderuesin eliminuar OE Arianit R.Krasniqi, të datës 23.6.2023, në arsyetim është shënuar se mungojnë specifikacionet, pa i përshkruar se cilat janë ato mangësi/dokumnete, që kane qenë kërkesa DT, andaj Paneli konstaton se kjo mënyrë e arsyetimit nuk është ne përputhje me kërkesat e ligjit te LPP-se nenit 108/A dhe 54 dhe krijon vështirësi në vlerësimin e pohimeve ankimore edhe për vete Panelin për të vlerësuar në mënyrë meritore pretendimet ankimor të ankuesit.

Paneli shqyrtues përkujton AK, se sipas nenit 108/A, pika 12 te LPP-së,Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, përcakton kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës .

Po ashtu neni 54, Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar, i LPP-së përcakton sekurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt.

Njoftimi i tillë duhet që së paku të përmbaje informatat të cilat shpjegojnë arsyet përkatëse në përputhshmëri me:1.1. në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati. 1.2. në rast të eliminimit të një

tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë. 1.3. në rast të një tenderuesi të pa-suksesshëm, që ka paraqitur tender të përgjegjshëm, njoftimi do të saktësojë karakteristikat dhe përparësitë përkatëse të tenderit fitues si dhe emrin e tenderuesit fitues.

B42 - Letër standarde për *[tenderuesin]* e eliminuar

23.06.2023
Komuna e Podujevës
Arianit R. Bytyqi, Prishtinë

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. **Mungojnë disa pika nga specifikacioni**
2. **Mungon dokumenti ku vërteton të drejtën e pronësisë së materialeve**

Vendimi i Komunës se Podujevës, lidhur me Kërkesën për Rishqyrtimi të ankuesit, i dt.10.8.2023, me mungese të argumenteve për refuzimin e ankesës, cilat kërkesa DT dhe dokumente nuk i ka dorëzuar ankuesi që u vlerësua si i OE i eliminuar, nga përshkrimi i mëposhtëm Paneli e ka të pamundur vlerësimin ligjor të pretendimeve ankimore.

Pretendimi ankimor I:
Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka proceduar në kundërshtim me:
- Neni 1 – paragrafi 1
- Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,6
- Neni 59 – paragrafi 1,3,4
- Neni 62 – paragrafi 1,2
- Neni 72 – paragrafi 1,2,3

Përgjigjeja lidhur me pretendimin I.
REFUZOHET SI I PA BAZUAR ky pretendim, arsyeshmërin për këto pretendime sepse AK ka vepruar në tërsi sipas LPP-se dhe RROUPP, andaj ne nuk kemi vepruar ne kundershtim me nenet e cekura për më tepër keto pretendime janë shtjelluar gjatë procedurave dhe ankesave paraprake nga ana juaj dhe se jane qeshtje te gjykuara (Res Judicata e aktiviteti i prokurimit të mbetet në fuqi Njoftimi për anulim).

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, e posaçërisht të Vendimit të AK të datës 18.10.2023, Letrës Standarde të AK, të datës 26.3.2023, dhe raportit të ekspertit shqyrtues, ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor" me numër të prokurimit 615-

22-11546-2-1-1, të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PODUJEVËS**
- OE - **Arianit R. Bytyqi**
- Arkivës së OSHP-së: